



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kryeministri

U R D H Ë R

Nr. 169, datë 27.7.2006

P Ë R

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRMINISTROR TË PUNËS,  
PËRGJEGJËS PËR PËRGATITJEN, HARTIMIN DHE NDJEKJEN E  
ZBATIMIT TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE “REFORMA  
NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË”, NË KUADËR TË  
STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.692, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë, “Konsolidimi i një sistemi planifikimi të integruar në Shqipëri””,

U R D H Ë R O J :

1. Ngritjen e grupit ndërministror të punës, përgjegjës për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë”.
2. Grupi i punës të kryesohet nga ministri i Drejtësisë dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
  - Zëvendësministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
  - Zëvendësministrin e Financave;
  - Zëvendësministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - Zëvendësministrin e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

- Zëvendësministrin e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit;
  - Zëvendësministrin e Brendshëm;
  - Zëvendësministrin e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Në mbledhjet e grupit të punës, në varësi të çështjeve, që do të diskutohen, thirren të marrin pjesë:
- titullarë të Komitetit për të Drejtat në Fushën e Pronës;
  - titullarë të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
  - ekspertë të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Integritit;
  - përfaqësues nga Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë vepron si koordinator ndërmjet këtij grupi pune dhe Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit Strategjik të Ndhmës së Huaj, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integritit.
5. Ministri i Drejtësisë ngarkon me detyrën e sekretariatit teknik punonjësin ose njësinë, që siguron mbështetje, teknike dhe logjistike, për grupin ndërministror të punës.
6. Ministri i Drejtësisë, me propozimin e grupit ndërministror të punës, krijon një grup teknik pune, me ekspertë në nivel drejtor ose specialistësh të lartë, nga ministritë pjesëmarrëse, të kryesuar nga zëvendësministri i Drejtësisë.
7. Për përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë”, zbatohen udhëzimet e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri, dhe manuali “Për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim, strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale”, që i bashkëlidhet urdhrit nr.134, datë 12.6.2006, të Kryeministrit.

8. Funkzioni, rregullat e funksionimit dhe detyrat e grupit ndërministror të punës e të grupit teknik përcaktohen nga ministri i Drejtësisë, në përputhje me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri.
9. Ngarkohet ministri i Drejtësisë, që, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit të punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Sali Berisha', is written over a horizontal line. The signature is fluid and cursive.

**SALI BERISHA**